



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0847

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Internat Security Association SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik i objekteve të APK-së. me numër të prokurimit 203-40300-25-767-2-1-1, me 15.10.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Internat Security Association SH.P.K., me nr. 2025/0847, e datës 02.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik i objekteve të APK-së. me numër të prokurimit 203-40300-25-767-2-1-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Sigurimi fizik i objekteve të APK-së. me numër të prokurimit 203-40300-25-767-2-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Internat Security Association SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.02.2025 AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik i objekteve të APK-së. me numër të prokurimit 203-40300-25-767-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 250,000.00 €.

Me 21.08.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE Jaguar Security Sh.P.K.

Me 25.08.2025, OE Internat Security Association SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 27.08.2025.

Me 02.09.2025, OE Internat Security Association SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0847, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Internat Security Association SH.P.K., lidhur me ankesën 0847/2025:

Pasqyra faktike dhe historiku i procedurës

Autoriteti kontraktues Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës (tutje referuar si AK), ka pranuar vendimin nga OSHP, vendimi Nr. 2025/0455 i datës 29.07.2025, ku në bazë të vendimit të OSHP-së është anuluar vendimi i AK – Agjencia Pyjore e Kosovës në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurim fizik të objekteve të APK-së”, me numër të prokurimit 203-40300-25-767-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 40300-25-002-211.

Bazuar në vendimin e OSHP-së me nr. 2025/0455 të datës 29.07.2025, AK është obliguar që të kthejë lëndën në rivlerësim dhe të bëjë rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë të përgjegjshëm, bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, përfshirë këtu kërkesat teknike dhe ofertën financiare.

Edhe përkundër faktit se AK është i obliguar të respektojë vendimin e OSHP-së dhe dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik gjatë vlerësimit të ofertave, AK ka vepruar në kundërshtim me vendimin e OSHP-së, me LPP-në si dhe me Rregulloren e Prokurimit Publik nr. 002/2024. Kjo për faktin se AK, gjatë rivlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë, përsëri nuk ka bërë analizën financiare mbi bazën e së cilës do të mund të analizonte ofertat financiare të OE-ve dhe të vërtetonte saktë se cila prej tyre është e përgjegjshme, bazuar në kriteret e dosjes së tenderit dhe në përgjigjet rreth pyetjeve sqaruese të cilat i ka dhënë vetë AK.

Pra, AK edhe kësaj here, në kundërshtim me vendimin e OSHP-së dhe me LPP-në, ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik i cili ka ofertuar me çmim të papërgjegjshëm. Me çmimin e

ofertuar, OE i shpërblyer me kontratë nuk mund të mbulojë kërkesat bazuar në dosjen e tenderit dhe përgjigjet e AK-së në pyetjet për sqarim, ku vetë AK ka kërkuar që të respektohen ligjet relevante, përfshirë edhe Ligjin e Punës. Prandaj, AK edhe kësaj radhe ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së, duke shpërblyer me kontratë OE “Jaguar Security SH.P.K.” me ofertën financiare në vlerën prej 236,338.56 euro, shumë kjo e cila nuk mund t’i mbulojë as për së afërmi kërkesat për pagat e punëtorëve sipas Ligjit të Punës – kriter të cilin e ka kërkuar vetë AK.

Për të sqaruar më në detaje situatën rreth korrespondencës së AK-së dhe përgjigjeve në pyetjet e parashtruara nga OE, paraqiten informatat më të detajuara si më poshtë:

a. Me datë 10.03.2025 dhe 20.03.2025, brenda afatit të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik, OE ka parashtruar pyetje drejtuar AK-së në platformën e-prokurimi për të sqaruar kushtet e tenderit, me theks të veçantë “nëse është kriter i vlerësimit të tenderit respektimi i pagës minimale dhe i Ligjit të Punës gjatë kalkulimit të çmimit”.

b. Përgjigja e AK-së ka qenë se “Duhet të respektohen të gjitha ligjet e aplikueshme në fuqi”.

c. AK ka publikuar pyetjet dhe përgjigjet në platformën e prokurimit elektronik lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Provë: Pyetja e parashtruar nga OE dhe përgjigja nga AK.

AK, në kundërshtim me vendimin e OSHP-së për këtë aktivitet prokurimi, përmes njoftimit të datës 21.08.2025, ka shpërblyer me kontratë OE “Jaguar Security”, i cili ka ofertuar me çmim prej 236,338.56 €, ndërsa OE ankuesin e ka shpallur të pasuksesshëm me pretendimin se nuk kishte ofertuar çmimin më të ulët në mesin e operatorëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

OE ankues, brenda afatit ligjor, me datë 25.08.2025, në pajtim me nenin 108/A par.1 nënpar. 3.2., ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të AK-së, mirëpo e njëjta kërkesë është refuzuar si e pabazuar.

Provë: Ankesa drejtuar AK-së “Kërkesë për rishqyrtim” e datës 25.08.2025;

Provë: Vendimi i AK-së “Vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazë pas vlerësimit” i datës 27.08.2025.

Për shkaqet që do të theksohen më poshtë, këtë kërkesë për rishqyrtim OE ankuesi e konsideron të bazuar, pasi AK me rastin e marrjes së vendimit për shpërblim me kontratë dhe vendimit për refuzim të ankesës ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të:

Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092;

Ligjit të Punës Nr. 03/L-212;

Rregullores së Prokurimit Publik Nr. 001;

Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, nenet 47 dhe 48; dhe

Vendimit të Kryeministrit për pagën minimale në Republikën e Kosovës.

II. Lidhur me shkeljet e dispozitave të LPP-së

AK, me rastin e shpërblimit me kontratë të OE “Jaguar Security SH.P.K.”, ka përsëritur shkeljet e LPP-së duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e saj, për shkak se OE fitues është dashur të shpallet i përgjegjshëm pasi oferta e tij nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe të dosjes së tenderit. Vendimi për të shpallur fitues një OE të përgjegjshëm përbën shkelje të dispozitave të LPP-së dhe të RRUOPP-së.

OE fitues “Jaguar Security SH.P.K.” është dashur të shpallet i përgjegjshëm nga AK, sepse:

AK nuk ka marrë për bazë vendimin e OSHP-së, por ka shpërblyer me kontratë një OE që nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, pasi ka ofertuar me çmim më të ulët se kërkesat e dosjes dhe sqarimet shtesë të dhëna nga vetë AK;

Kalkulimi i pagës nuk është bërë duke iu përmbajtur kërkesave të dosjes së tenderit dhe sqarimeve të AK-së;

Nuk është bërë analizë e çmimit për bazimin e vendimit;

Çmimi i ofertuar është në kundërshtim me nenet 55–59 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, si dhe me Vendimin e Qeverisë për pagën minimale në Republikën e Kosovës (Vendimi Nr. 02/218, datë 28.08.2024).

II.1. Lidhur me kalkulimin e pagës bruto në kundërshtim me njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe sqarimet e AK-së

OE fitues nuk i është përmbajtur kërkesave të parashtruara në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe sqarimeve të dhëna nga AK sa i përket kalkulimit të pagës bruto mujore të punëtorëve. Bazuar në përgjigjet për pyetjet sqaruese, AK ka kërkuar që të respektohet Ligji i Punës.

OE “International Security Association” i është përmbajtur në përpikëri këtij kriteri dhe sqarimit të dhënë nga AK, duke llogaritur ofertën në përputhje me kërkesat e dosjes, përgjigjet e AK-së dhe dispozitat ligjore.

Edhe pse AK ka kërkuar respektimin e dispozitave ligjore në përgjigjet për pyetje, këtë kriter nuk e ka respektuar gjatë vlerësimit të ofertave, duke rekomanduar për kontratë OE-në që ka ofertuar çmim me të cilin nuk mund të mbulohen kërkesat ligjore. Oferta e fituesit është qartazi në kundërshtim me kërkesën për pagën minimale bruto prej 350.00 € për punëtorët e sigurimit sipas vendimit të Qeverisë dhe me shtesat për punë nate (+30%), vikende e festa (+50%), si dhe pagesën e pushimit vjetor.

Për të vërtetuar këtë pretendim, në ofertë është bashkëngjitur tabela e llogaritjes së çmimit dhe pagave për punëtorë, e cila tregon qartë çmimin minimal të mundshëm bazuar në kërkesat e tenderit dhe të Ligjit të Punës.

Provë: Tabela e llogaritjes së çmimit dhe pagave për punëtorë.

Me këtë veprim, AK ka shkelur nenet 7, 53, 57, 59, 60 dhe 61 të LPP-së, të cilat garantojnë barazinë në trajtim, sqarimin e tenderit, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, si dhe eliminimin e tenderëve me çmime jonormalisht të ulëta.

II.2. Lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për pagën minimale në nivel vendi

Po ashtu, AK, me rastin e shpalljes fitues të OE “Jaguar Security SH.P.K.”, nuk ka marrë për bazë Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës, i cili është obligativ për të gjitha bizneset dhe duhet të respektohet në përpikëri. Neni 57 (Paga minimale), paragrafët 1 dhe 2, i Ligjit të Punës parashikon se për punën më të gjatë se orari i plotë, për punën në ditë feste dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në përputhje me këtë ligj, marrëveshjet kolektive dhe kontratën e punës. Paragrafi 2 specifikon përqindjet shtesë të pagës bazë: 20% për kujdestari; 30% për punë gjatë natës; 30% për punë jashtë orarit; 50% për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50% për punë gjatë fundjavave. Neni 57.3 përcakton se paga minimale llogaritet mbi bazën e orëve të punës për periudhën njëvjeçare dhe publikohet në Gazetën Zyrtare, ndërsa Neni 57.4 parashikon mundësinë e përcaktimit të pagës minimale me marrëveshje në nivele të ndryshme, që nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale kombëtare.

Neni 58 (Kompensimi i pagës), paragrafi 1, thotë se i punësuari ka të drejtë për kompensim në rastet si: gjatë ditëve të festave në të cilat nuk punohet; gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor; gjatë aftësimit dhe përgatitjes profesionale; dhe gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet. Neni 32 (Kompensimi i pushimit vjetor), paragrafi 1, përcakton se i punësuari ka të drejtë për pushim vjetor të paguar prej së paku katër (4) javësh brenda çdo viti kalendarik. Neni 59 (Kompensimi i pushimit mjekësor), paragrafi 1, parashikon se i punësuari ka të drejtë për pushim mjekësor deri në njëzet (20) ditë pune brenda një viti me kompensim prej 100% të pagës.

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/218, datë 28.08.2024, përcakton shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale. Në pikën 1 të vendimit aprovohet propozimi i Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për përcaktimin e pagës minimale në nivelin prej 2.00 € (dy euro) për një orë pune të rregullt, ose 350.00 € (treqind e pesëdhjetë euro) bruto në muaj për punë me orar të plotë. Pika 2 e vendimit përcakton se paga minimale e përmendur në pikën 1 fillon të zbatohet nga data 1 tetor 2024.

Në fakt, OSHP duhet të ketë parasysh se AK nuk ka bërë asnjë përmirësim të gabimeve aritmetike të evidentuara më lart dhe të bëra nga OE fitues; këto gabime aritmetike janë të qarta, por AK i ka injoruar dhe nuk ka reaguar ndaj tyre. Në këto rrethana, AK ka qenë e detyruar që, në kuadër të verifikimit të ofertave dhe në përputhje me rekomandimet e OSHP-së për analizë të çmimit, ta eliminojë OE “Jaguar Security SH.P.K.” si të papërgjegjshëm.

OSHP duhet të ketë parasysh edhe faktin se AK nuk ka marrë për bazë asnjë kriter të përcaktuar në dosjen e tenderit dhe sqarimet e dhëna në pyetjet që kemi parashtruar për të sqaruar dosjen dhe kriteret e tenderit. Ky veprim përbën shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, Ligji Nr. 05/L-031, veçanërisht nenet 47 dhe 48.

Autoriteti kontraktues, në vendimin e nxjerrë më datë 27.08.2025, titulluar “Vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pa bazë pas vlerësimit”, e ka nxjerrë këtë vendim në kundërshtim me rekomandimet e vendimit të OSHP-së. Po ashtu, në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues nuk ka vepruar konform nenit 108/A, paragrafi 12, i cili parasheh: “Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe t’u komunikohen me shkrim parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë”. Në vendimin e tij për refuzim, AK nuk ka dhënë

arsyetim dhe nuk i ka përgjigjur pretendimeve ankimore.

Prandaj, AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, Nr. 05/L-031, neni 47 (Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar) dhe neni 48 (Arsyetimi i një akti administrativ), pasi vendimi është nxjerrë pa dhënë arsyetimin e plotë lidhur me dispozitivin e vendimit.

III. PËRFUNDIM

I tërheqim vëmendjen OSHP-së se AK, me rastin e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë që kanë konkurruar në këtë proces prokurimi edhe pas vendimit të OSHP-së, ka marrë vendim për shpërblim me kontratë për një OE fitues me çmim jo të përgjegjshëm, pa zbatuar kriteret dhe pa pasur bazë ligjore. Në të njëjtën kohë, AK ka shpallur të pasuksesshëm OE “International Security Association”, me arsyetimin se çmimi i ofruar nuk ishte çmimi më i lirë, duke mos marrë parasysh se oferta jonë ishte në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, sqarimet e dhëna nga AK dhe dispozitat ligjore, përfshirë Ligjin e Punës dhe Vendimin e Qeverisë për pagën minimale.

Gjithashtu, AK ka hedhur poshtë kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga OE “International Security Association”, e cila ishte e mbështetur në fakte dhe prova të dokumentuara dhe të besueshme. Për rrjedhojë, AK ka nxjerrë një vendim të pa bazuar dhe në kundërshtim me rekomandimet e vendimit të OSHP-së, si dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (neni 108/A) dhe Ligjit për Procedurën Administrative (nenet 47 dhe 48).

Duke marrë parasysh këto fakte, konsiderojmë se AK ka marrë vendim të kundërligjshëm sepse:

ka trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe jo të barabartë operatorët ekonomikë;

ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik të papërgjegjshëm, sepse oferta e tij nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, veçanërisht sa i përket kalkulimit të pagës bruto prej 350.00 € për një punëtor dhe kërkesave të tjera të dalura nga dispozitat ligjore.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Me datë 25.08.2025, OE ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontratë, të datës 21.08.2025, lidhur me ri-vlerësimin e aktivitetit të prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të APK-së”, me numër prokurimi 203-40300-25-767-2-1-1 dhe numër të brendshëm 40300-25-002-211.

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 03.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0847, ndërsa me datë 14.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0847. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEInternat Security Association SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0847, ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues: AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS

Numri i prokurimit: 203-40300-25-767-2-1-1,

Titulli i kontratës: Sigurimi fizik i objekteve të APK-së

Njoftimi për kontratë: 18.02.2025

Hapja e ofertave: 02.04.2025

Vlera e parashikuar e kontratës: 250,000.00

PËR HEREN E PARË

Njoftimi i vendimit të autoritetit kontraktues është marrë me date: 22.05.2025, duke shpallur fitues operatorin ekonomik DEFEC SECURITY SH.P.K

Kërkesa për ri-shqyrtim nga operatori ekonomik ankues "Internat Security Association" SH.P.K. është bërë me datë: 26.05.2025.

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga autoriteti kontraktues, është marrë me datë: 28.05.2025.

Pas refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim nga autoriteti kontraktues operatori ekonomik ankues "Internat Security Association" SH.P.K. ka parashtruar ankesë me date: 05.06.2025

Vendimi i Panelit Shqyrtues nga OSHP, është marrë me date 29.07.2025, duke kërkuar që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

PËR HEREN E DYTË

Njoftimi i vendimit të autoritetit kontraktues është marrë me datë: 21.08.2025 duke shpallur fitues operatorin ekonomik JAGUAR SECURITY.

Kërkesa për ri-shqyrtim nga operatori ekonomik ankues "Internat Security Association"SH.P.K. është bërë me date: 25.08.2025

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga autoriteti kontraktues, është marrë me datë: 27.08.2025

Pas refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim nga autoriteti kontraktues operatori ekonomik ankues JAGUAR SECURITY. ka parashtruar ankesë me datë: 02.09.2025

Përmbledhje e pretendimeve të operatorit ekonomik ankues "Internat Security Association"SH.P.K.

Operatori ekonomik ankues pretendon se autoriteti kontraktues AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS ka bërë shkelje të neneve Neni 7 Neni 53 Neni 57.

Sqaroj se pretendimet e operatorit ekonomik ankues, janë të njëjta me pretendimet në ankesës e pare të datës 29.07.2025, ku për të njëjtën është marrë Vendim nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, vendimi me numër 2025/0455 i datës: 29/07/2025.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ndërlidhen me pagesat për orë pune për puntorët e sigurimit fizik për 1 (një) orë pune.

Tutje, OE-ankues në pretendimet e tij sqaron se është shkelur legjislacioni lidhur me pagën minimale për pagesën për një ore pune, si - Ligjit të Prokurimit Publik Nr, 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; - Ligjit të Punës Ligji Nr. 03/L-212; - Rregulloren e Prokurimit Publik 001; - Ligjin për procedurën Administrative, Ligji Nr. 05/L-031, neni 47 dhe 48 dhe - Vendimin e Kryeministrit rreth Pagës Minimale në Republikën e Kosovës.

Sqarim lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues

Bazuar në vendimim paraprak të panelit të OSHP-së me numër 2025/0455 i datës: 29/07/2025, ku pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të njëjta me pretendimet në ankesën paraprake, andaj të njëjtat konsiderohen si çështje res judicata.

Sqaroj se autoriteti kontraktues me rastin e trajtimit të pretendimeve duhet ti ketë parasysh të gjeturat për trajtim nga vendimi paraprak i Panelit të OSHP-së, dhe ti trajtoj pretendimet bazuar në legjislacionin në fuqi dhe sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, poashtu edhe në përgjigjet e sqarimeve të dhëna gjatë fazës së njoftimit për kontratë, pasi që përgjigjet e autoritetit kontraktues kanë qenë objekt sqarimi edhe në fazën e kërkesës për sqarim.

Gjatë ri-vlerësimit autoriteti kontraktues duhet të ketë referencë ligjore për trajtimin e pretendimeve, legjislacionin në fuqi përkatësisht:

LIGJI Nr. 03/L-212 - PAGA DHE BENEFICIONET E TË PUNËSUARVE Neni 55 Paga, kompensimi i pagës dhe të ardhurat e tjera Neni 56

Paga shtesë

1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuar ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.

2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:

2.1. 20 % në orë për kujdestari;

2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;

2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;

2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe

2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.

Poashtu edhe vendimin e Qeverisë nr. 02/218 të datës: 28.08.2025.

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura sqaroj se ankesa e operatorit ekonomik ankues të konsiderohet e bazuar të anulohet njoftimi për dhënje dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik i objekteve të APK-së. me numër të prokurimit 203-40300-25-767-2-1-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ja fal besimin konstatimit dhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues se ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënje të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e

tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS**
- **OE - "Internat Security Association"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: